

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI****VENDIM****Nr. 173, Datë 04.11.2020****“MBI****RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SH.P.K., NR. 306, SERIA FK15, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S, NR. 105, DATË 18.08.2015”.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “d”; nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 8, 9 dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 116/3 Prot, datë 22.10.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi kërkesën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 134, datë 10.08.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/22 prot, datë 11.08.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k.,
- Me shkresën nr. 947/1 prot, datë 13.08.2020, ERE i’u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k. me shkresën nr. 31 prot, datë 20.08.2020, protokolluar në ERE me nr. 974/2 prot, datë 21.08.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 151, datë 18.09.2020, vendosi të shtyjë vendimmarrjen pasi gjetoi të nevojshme që shoqëria të dërgojë në ERE informacion/sqarime shtesë për dokumentacionin në lidhje me sigurimin e energjisë elektrike dhe të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar.

- Shoqëria në përgjigje të shkresës së ERE-s me nr. 974/6 prot, datë 21.09.2020, me e-mailin e datës 14.10.2020, ka përcjellë dokumentacionin dhe sqarimet e kërkuara.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 26.06.2008 është e regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), konform ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për qendrën kombëtare të biznesit ”.
- Shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 306, Seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 105, datë 18.08.2015.
- Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si më poshtë:
 - **Formati dhe dokumentacioni për aplikim** (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor** (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - **Dokumentacioni financiar dhe fiskal** (neni 9, pika 3), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - **Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike** (neni 9, pika 4.7) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - **Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar** (neni 9, pika 4.7.1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 306, Seria FK15, të shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 105, datë 18.08.2015, për një afat 5-vjeçar duke filluar nga data 19.08.2020.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI